

Referenca: 2020-COS-0317

Fidelma Donlon  
Administratore  
Dhomat e Specializuara të Kosovës  
Hagë  
Holandë

Prishtinë, 30 tetor 2020

Lënda: Parashtrim me shkrim nga shefi i Misionit të Sundimit të Ligjit të Bashkimit Evropian në Kosovë (EULEX Kosova) mbi pranueshmërinë e Referimit KSC-CC-2020-11 për amendamentin e propozuar të Kushtetutës së Kosovës nga Kryetarja e Kuvendit të Kosovës

E nderuar znj. Donlon,

Pas vendimit të panelit për zgjatjen e afatit për paraqitjen e parashtrimeve lidhur me këtë çështje, ju lutem pranoni bashkëngjitur parashtrimin përkatës për t'ia përcjellë panelit.

Me nderime,  
/nënshkrimi/  
Lars-Gunar Uigemark (Lars-Gunnar Wigemark)  
Shef i Misionit  
EULEX Kosova

Bashkëngjitur: Parashtrimi me shkrim nga shefi i Misionit të Sundimit të Ligjit të Bashkimit Evropian në Kosovë (EULEX Kosova) mbi pranueshmërinë e Referimit KSC-CC-2020-11 për amendamentin e propozuar të Kushtetutës së Kosovës nga Kryetarja e Kuvendit të Kosovës

Referenca: 2020-COS-0317

Gjykatës Vidar Stensland  
Kryegjykatës  
Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës  
Hagë  
Holandë

Prishtinë, 2 nëntor 2020

Lënda: Parashtrim me shkrim nga shefi i Misionit të Sundimit të Ligjit të Bashkimit Evropian në Kosovë (EULEX Kosova) mbi pranueshmërinë e Referimit KSC-CC-2020-11 për amendamentin e propozuar të Kushtetutës së Kosovës nga Kryetarja e Kuvendit të Kosovës

Referencat: Vendimi KSC-CC-2020-11/F00004 i 5 tetorit 2020 mbi njoftimin e Referimit dhe kërkesën për informacion

## Hyrje

1. Më 5 tetor 2020, Administratorja e Dhomave të Specializuara i përcolli shefit të Misionit të Sundimit të Ligjit të Bashkimit Evropian në Kosovë (EULEX Kosova) një njoftim në lidhje me protokollimin e Referimit KSC-CC-2020-11/F00004 të dorëzuar në Dhomën e Specializuar të Gjykatës Kushtetuese ("Gjykata") dhe për ftesën nga paneli i Gjykatës që është caktuar për vlerësimin e referimit, për paraqitjen e parashtrimeve, nëse dëshiron ta bëjë këtë, mbi pranueshmërinë dhe themelësinë e Referimit, deri më 19 tetor 2020.
2. Pas iu miratua kërkesa për zgjatjen e afatit deri më 2 nëntor 2020, shefi i Misionit paraqet parashtrimin e mëposhtëm në përgjigje të kërkesës së lartpërmendur.

## Lënda

3. Shefi i Misionit vlerëson se lënda e Referimit është vlerësimi i amendamentit të propozuar dhe se a e pakëson ky amendament ndonjë nga të drejtat dhe liritë e garantuara me Kapitullin II të Kushtetutës së Kosovës.
4. Në nenin 162(13) dhe (14) aktualisht thuhet:

*“13-Mandati i Dhomave të specializuara dhe Zyrës së Prokurorit të specializuar do të zgjasë për një periudhë pesëvjeçare (5), përveç nëse njoftimi i përfundimit të mandatit në pajtim me Ligjin Nr. 04/L-274 bëhet më herët.*

*14-Në mungesë të njoftimit për përfundim të mandatit sipas paragrafit 12, mandati i Dhomave të specializuara dhe i Zyrës së Prokurorit të Specializuar do të vazhdojë deri kur njoftimi i përfundimit të mandatit të bëhet në përputhje me Ligjin Nr. 04/L-274 dhe në konsultim me Qeverinë.”*

5. Në amendamentin e propozuar thuhet:

"Paragrafi 13 i nenit 162 [Dhomat e Specializuara dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar], fshihet dhe riformulohet me tekstin në vijim:

*13. Mandati i Dhomave të Specializuara dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar do të vazhdojë deri kur njoftimi i përfundimit të mandatit të bëhet nga Këshilli i Bashkimit Evropian dhe në konsultim me Qeverinë e Republikës së Kosovës.”*

Paragrafi 14 i nenit 162 [Dhomat e Specializuara dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar], fshihet.”

6. Rrjedhimisht, shefi i Misionit vlerëson se, nëse amendamenti i propozuar do të miratohej përfundimisht nga Kuvendi, rezultati do të ishte që do të hiqeshin të gjitha referencat e Ligjit Nr. 04/L-274 që aktualisht i përmban neni 162 i Kushtetutës.

#### **Ligji Nr. 04/L-274**

7. Shefi i Misionit rikujton se, më 14 prill 2014, Presidentja e Kosovës dhe Përfaqësuesja e Lartë e Bashkimit Evropian për Politikë të Jashtme dhe të Sigurisë/Zëvendëspresidentja e Komisionit Evropian bënë Shkëmbimin e Letrave.

8. Sipas këtij Shkëmbimi të Letrave të vitit 2014, Presidentja e Kosovës u zotua me shkrim dhe mori përsipër që të konsultohet me institucionet e BE-së në Kosovë, veçanërisht me EULEX-in në Kosovë, për çfarëdo ndryshimesh të propozuara që do mund të kishin ndikim në ushtrimin e mandatit të EULEX-it si dhe në proceset gjyqësore që burojnë nga hetimet e Task Forcës Speciale Hetimore (TFHS).

Në faqen 4 të Shkëmbimit të Letrave thuhet:

*“ ...marrim përsipër, në pajtim me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi në Kosovë, me Shefin e Misionit EULEX Kosova dhe/ose PSBE (siç kërkohet), të gjitha zotimet dhe modalitetet përcjellëse të domosdoshme për të mundësuar funksionimin efektiv të misionit EULEX Kosova, duke përfshirë konsultime në procesin e ndryshim-plotësimit të ligjeve që kanë ndikim në ushtrimin e mandatit të misionit EULEX Kosova, si dhe për*

*procedurat gjyqësore që iniciohen si rezultat i hetimeve nga TFSH-ja, si dhe PSBE-së në ushtrimin e mandatit të tij. [...]*”.

9. Më 23 prill 2014, Kuvendi i Kosovës e ratifikoi Shkëmbimin e Letrave të vitit 2014 midis Presidentes së Republikës së Kosovës dhe Përfaqësueses së Lartë të BE-së përmes Ligjit Nr. 04/L-274, duke konfirmuar kështu pëlqimin e Kosovës që të jetë e obliguar nga Shkëmbimi i Letrave në të gjithë përmbajtjen e tij, duke përfshirë, në veçanti, angazhimin dhe zotimin për t'u konsultuar me EULEX-in në Kosovë në rrethanat e përshkruara në paragrafin 8 më lart.

10. Më 7 maj 2014, Presidentja e Kosovës, me Dekretin Nr. DL022-2014, shpalli Ligjin Nr. 04/L-274 të lartpërmendur dhe pas botimit në Gazetën Zyrtare të Kosovës, Ligji hyri në fuqi pas 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh.

11. Ligji Nr. 04/L-274 mbetet në fuqi dhe nuk është shfuqizuar.

12. Më 3 gusht 2015, Kuvendi i Kosovës e ndryshoi Kushtetutën duke miratuar nenin 162, i cili i referohet drejtpërdrejtë Ligjit Nr. 04/L-274.

### **Pranueshmëria e Referimit**

13. Në mënyrë që të jetë në gjendje ta vlerësojë Referimin, së pari Gjykata duhet që të shqyrtojë nëse janë plotësuar kushtet e pranueshmërisë të përcaktuara në Kushtetutë dhe gjithashtu të saktësuara në Ligjin për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, Ligji Nr. 05/L-053, si dhe në Rregulloren e Procedurës dhe të Provave të Dhomave të Specializuar të Gjykatës Kushtetuese.

14. Shefi i Misionit vlerëson se, përveç aspekteve paraprake të pranueshmërisë se a është parashtruesi i kërkesës person i autorizuar ose a ka Gjykata juridiksion për lëndën e Referimit, kritere që duket se plotësohen, Rregullorja e Procedurës dhe e Provave e Dhomave të Specializuara të Gjykatës Kushtetuese, në faqen 114, rregulla 14, ka përcaktuar kritere të veçanta shtesë për çdo referim të parashtruar në përputhje me nenin 49 të Ligjit Nr. 05/L-053. Në veçanti, rregulla 14(f) parasheh që referime të tilla janë të papranueshme dhe hidhen poshtë pa u shqyrtuar nëse:

*“... pas shqyrtimit prima facie, paneli gjykon se referimi përbën keqpërdorim të procesit dhe/ose duket se asgjë në referim nuk krijon përshtypjen e mospërputhshmërisë me Kushtetutën, ose të një shkeljeje të një të drejte kushtetuese.”*

15. Shefi i Misionit mendon se e drejta për shpalljen e një referimi të papranueshëm dhe hedhjen poshtë të tij buron nga detyra madhore e Gjykatës që të promovojë drejtësinë dhe të parandalojë padrejtësinë.

16. Shefi i Misionit rikujton edhe një herë Shkëmbimin e Letrave të vitit 2014, si dhe Ligjin 04/L-274, përmes të cilit u ratifikua Shkëmbimi i Letrave i vitit 2014.
17. Shefi i Misionit dëshiron të theksojë se, përkundër obligimit ligjor, Presidenti i Kosovës në asnjë fazë nuk është konsultuar me EULEX-in në Kosovë para se t'ia paraqiste amendamentin e propozuar Kryetares së Kuvendit të Kosovës për referim, e as nuk është konsultuar me EULEX-in në Kosovë në lidhje me çështjen e propozimeve të amendamenteve të kësaj natyre të Kushtetutës .
18. Shefi i Misionit vlerëson se Kushtetuta e Kosovës është ligji më i lartë i Kosovës dhe rrjedhimisht obligimet e përfshira në Shkëmbimin e Letrave të vitit 2014 vlejné në mënyrë të barabartë për çdo ndryshim të Kushtetutës.